



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"
VLORE
ZYRA PROTOKOLL-ARKIVËS
Nr. 82130 Prot.
Datë: 09.01.2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

Nr. _____ Prot.

Vlorë, më 09.01.2020

VENDIM

Nr. 30, datë 9.01.2020

**PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË DEPARTAMENTIT TË INXHINIERIVE DHE
TEKNOLOGJIVE DETARE**

Mbështetur në shkronjën **d** të pikës **1** në nenin **38** në ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", shkronjën **dh** të pikës **1** në nenin **19** në Statutin e UV-së, Senati Akademik në mbledhjen e datës 9.01.2020

VENDOSI:


1. Të miratojë rregulloren e Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjive Detare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI





REPUBLIKA E SHQIPËRIË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

**RREGULLORE E BRENDSHME E FUNKSIONIMIT DHE ORGANIZIMIT TE
DEPARTAMENTIT TE INXHINIERIVE DHE TEKNOLOGJISE DETARE**



Adresa /Adress: L. Pavarësia,
Bulevardi Vlorë-Skele

Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

NENI 1

BAZA LIGJORE

1. Kjo rregullore është hartuar duke mbajtur në konsideratë:
 - a. Ligjin Nr 80/2015 datë 22/07/2015 për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë.
 - b. Statutin e Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës
 - c. Rregulloren e Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës.

NENI 2

**ROLI DHE MISIONI I DEPARTAMENTIT TE INXHINIERIVE DHE TEKNOLOGJISE
DETARE**

1. TE PERGJITHSHME

Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare (DITD) është struktura më e vjetër akademike brenda Fakultetit të Shkencave Teknike (FSHT), i krijuar me hapjen e "Universitetit të Vlorës "Ismail Qemali" (UV) në vitin 1994 (VKM 105, 28/02/1994), si pjesë e Fakultetit të Marinës (FM), aktualisht Fakulteti i Shkencave Teknike.

Fillimisht Departamenti ka mbajtur emërtesën Departamenti i Inxhinierisë Navale (DIN) dhe prej vitit akademik 2015-2016 Departamenti mban emërtesën që ka aktualisht Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare (DITD).

DITD është krijuar nga bashkimi i njësive bazë "Departamenti i Inxhinierisë Mekanike dhe Navale" dhe "Departamenti i Inxhinierisë Elektrike". Departamenti dallohet brenda Fakultetit të Shkencave Teknike, si një prej Departamenteve me staf akademik me një kualifikim të lartë shkencor, akademik dhe profesional, duke plotësuar të gjitha kriteret që burojnë nga ligji i Arsimit të Lartë dhe standardet e cilësisë në vendin tonë.

DITD ofron programe studimi të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë. Programet e studimit që aktualisht ofrohen në DITD janë:

Programe studimi të ciklit të parë.

- Bsc në Inxhinieri Navale
- Bsc në Inxhinieri Mekanike
- Bsc në Inxhinieri Elektrike





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

Programe studimi të ciklit të dytë.

- Msc në Inxhinieri Navale
- MP në Operacione Industriale dhe Navale.

2. Roli dhe Misioni i DITD^{se}

DITD është njësi bazë mësimore-kërkimore, brenda Universitetit të Vlorës "Ismail Qemali"/Fakulteti i Shkencave Teknike ka për mision:

- ✓ të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe bashkëveprimit me shoqërinë sipas fushave të tij të ekspertizës.
- ✓ Formimin e specialistëve të lartë dhe përgatitjen e shkencëtarë të rinj të aftë për tregun e punës në nivel kombëtar dhe rajonal në fushën e teknologjive detare, mekanike dhe elektrike. në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në zhvillimet ekonomike, social dhe kulturore në nivel kombëtar dhe rajonal.
- ✓ Specializimin në fusha specifike të industrisë detare, mekanike, elektrike të studentëve tanë të cilët të jenë të aftë në menaxhimin dhe drejtimin në institucione prodhuese dhe shërbimi.
- ✓ Pozicionimin si një prej institucioneve qëndrore në Shqipëri për diplomim universitar në nivelet bachelor e master të inxhinierëve naval, mekanikë dhe elektrikë, ku aktorët e interesuar do të gjejnë përgjigje dhe gatishmëri bashkëpunuese në projekte teknike, profesionale dhe kërkimore-shkencore.
- ✓ Të integrojë mësimdhënien me kërkimin shkencor sipas fushave përkatëse.
- ✓ Të nxisë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushat e Inxhinierisë Detare, Mekanike, Elektrike me Institucione Kërkimore dhe të Arsimit të Lartë.

NENI 3 .

PARIMET BAZË TË FUNKSIONIMIT TË DEPARTAMENTIT TË INXHINIERIVE DHE TEKNOLOGJISË DETARE.

1. Veprimtaria dhe funksionimi i Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare bazohet në respektimin e lirisë akademike, autonomisë financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit akademik dhe jo akademik, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Në Departamentin e Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare liria akademike garantohej nëpërmjet të drejtës që gëzon Departamenti për:
 - a. të organizuar veprimtaritë e mësimdhënies, ato kërkimore-shkencore, të inovacionit, si dhe veprimtaritë krijuese;
 - b. për të hartuar dhe zhvilluar programet e studimit dhe për të përcaktuar fushat e veprimtarisë kërkimore-shkencore;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

- c. për të organizuar procesin e promovimit të personelit akademik, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- d.
3. Në Departamentin e Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare autonomia financiare garantohej nëpërmjet së drejtës për:
 - a. të krijuar të ardhura të ligjshme nga veprimtaritë e mësimdhënies, nga veprimtaritë kërkimore-shkencore, nga të drejtat intelektuale, nga markat dhe patentat, nga shërbimet, nga veprimtaritë artistike e sportive, si dhe nga veprimtari të tjera ekonomike, të cilat përdoren në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - b. për të përfituar fonde nga fondet publike dhe organizma të tjerë;
 - c. për të përcaktuar tarifat e studimit, në përputhje me këtë ligj;
 - d. për të administruar asetet e luajtshme dhe të paluajtshme që DITD zotëron në përputhje me misionin e tij.
 - e. të menaxhuar fondet bazë të kërkimit shkencor apo fonde të tjera që gjenerohen nga burime të ligjshme, publike ose jopublike, kombëtare ose ndërkombëtare.
4. Në Departamentin e Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare Autonomia Organizative dhe e përzgjedhjes së personelit garantohej nëpërmjet së drejtës për:
 - a. të zgjedhur Autoritetet Drejtuese, për të organizuar strukturat e brendshme të Departamentit dhe për të rregulluar mënyrat e ushtrimit të veprimtarisë së tyre nëpërmjet akteve të brendshme të Departamentit, duke respektuar kuadrin ligjor, nënligjor dhe institucional në fuqi.
 - b. të caktuar kritere për pranimin e studentëve në programet e studimit, që ofron Departamenti
 - c. të lidhur marrëveshje me persona juridikë, publikë dhe privatë, vendas ose të huaj, për zhvillimin e veprimtarive mësimdhënëse, kërkimoreshkencore, kualifikuese, inovative, si edhe veprimtari të tjera të ligjshme;
 - d. të ofruar shërbime për të tretë, si dhe të zhvillojë veprimtari të tjera, sipas legjislacionit në fuqi dhe rregullave të përcaktuara në statutin dhe aktet e tjera të Universitetit Ismail Qemali.
 - e. për të caktuar në mënyrë të pavarur numrin e personelit, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së tij.

NENI 4.

DREJTUESI I NJËSISË BAZË, (PËRGJEGJËSI I DEPARTAMENTIT)


1. Drejtuesi i njësisë bazë ose Drejtuesi i departamentit është Autoriteti më i Lartë Drejtues Akademik i njësisë dhe e përfaqëson atë.
2. Zgjedhja e Drejtuesit të Departamentit bëhet në përputhje me kuadrin Ligjor në fuqi.
3. Përveç kompetencave të përcaktuara në ligjin e arsimit të lartë, Drejtuesi i Departamentit ka edhe këto kompetenca, të përcaktuara në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit të Vlorës Ismail Qemali:
 - a. përfaqson DITD në organet e UV-së dhe në marrëdhëniet me të tretët për çështjet akademike dhe protokollare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

- b. drejton dhe kontrollon veprimtarinë e DITD-së për çështjet Akademike dhe protokollare.
- c. përgjigjet për zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore, të statutit dhe të rregulloreve të UV-së në njësinë bazë.
- d. i përcjell Drejtuesit të njësisë kryesore propozime njësisë për programet e reja të studimit.
- e. i përcjell Drejtuesit të njësisë kryesore propozimin e DITD-së për kriteret e pranimit të studentëve për secilin program studimi të ofruar nga DITD.
- f. i përcjell Drejtuesit të njësisë kryesore propozimin e DITD-së për kriteret e rekrutimit për personelin akademik dhe të personelit ndihmës akademik.
- g. i përcjell drejtuesit të njësisë kryesore propozimin e njësisë bazë për miratimin e dhënies së vitit akademik sabatik të kërkuar nga personeli akademik i njësisë bazë, që i përket kategorisë "Lektor dhe "Profesor".
- h. i përcjell Drejtuesit të njësisë kryesore propozimin e njësisë bazë për personelin akademik të ftuar që do të kërkohet të punësohet me kontratë për periudha të shkurtra kohore.
- i. krijon dhe drejton komisionin përgjegjës për procesin e përzgjedhjes së kandidatëve për student fitues dhe miraton listën e fituesve.
- j. përcakton ngarkesën mësimore për personelin akademik të njësisë bazë, pasi ka marrë mendimin e anëtarëve të njësisë bazë dhe ia përcjell Drejtuesit të njësisë kryesore për miratim.
- k. i propozon Drejtuesit të njësisë kryesore përgjegjësit e grupeve mësimore dhe kërkimore.
- l. i propozon Drejtuesit të njësisë kryesore përbërjen e komisioneve të provimeve të formimit dhe të mbrojtjes së diplomave.
- m. përcakton përfaqësuesit e njësisë bazë anëtarë në komisionin AD_HOC për konkursin e rekrutimit të personelit akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme për njësinë bazë dhe ia përcjell për miratim drejtuesit të njësisë kryesore.
- n. përcakton përfaqësuesit e njësisë bazë anëtarë në komisionin AD_HOC për konkursin e rekrutimit të personelit ndihmës akademik në shërbim të njësisë bazë dhe ia përcjell për miratim drejtuesit të njësisë kryesore.
- o. miraton paraprakisht kërkesën e personelit akademik me kohë të plotë të njësisë bazë, për tu angazhuar me kohë të pjesshme në një institucion tjetër të arsimit të lartë.
- p. Harton planin strategjik të zhvillimit të njësisë bazë, pasi ka marrë mendimin e anëtarëve të njësisë bazë dhe ia përcjell drejtuesit të njësisë kryesore.
- q. Drejton punën për hartimin e kurrikulave të programeve studimit që mbulon departamenti dhe ndjek me korrektësi zbatimin e tyre.
- r. Ndjek e kontrollon aktivitetin shkencor në departament, në përputhje me planifikimin vjetor dhe mban dokumentacionin e aktivitetit shkencor e akademik të anëtarëve të departamentit, pas raportimeve në analizën vjetore të tij.
- s. Harton orarin mësimor dhe bashkërendon shpërndarjen e ngarkesës mësimore në Departament.
- t. Organizon analizën vjetore të punës mësimore shkencore, analiza periodike ose analiza të tjera për raste e aspekte të veçanta në departament





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

- u. Mbikqyr respektimin e programeve të mësimdhënies, të kërkimeve shkencore dhe të veprimtarive të tjera, në kohën e në mënyrën e caktuar;
 - v. Mbikqyr respektimin e disiplinës në punë, merr masat përkatëse për rivendosjen e rregullit në raste shkeljesh apo të metash.
- 4. Drejuesi i njësisë bazë në ushtrimin e kompetencave të tij, shprehet me urdhëra, udhëzime dhe akte të tjera, sipas legjislacionit në fuqi.
 - 5. Përgjegjësi i njësisë bazë bashkëpunon me asamblenë e stafit akademik të DITD-së për të diskutuar ngarkesën që do të mbulojnë gjatë vitit akademik.
 - 6. Përgjegjësi i njësisë bazë duke bashkëpunuar me përgjegjësit e grupeve të përhershme/përkohëshme mësimore dhe kërkimore nxit veprimtarinë kërkimore në Departamentin e Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare.

NENI 5


**VENDIMARRJA NË DEPARTAMENTIN E INXHINIERIVE DHE TEKNOLOGJISË
DETARE**


- 1. Për të diskutuar çështje që lidhen me mirëfunksionimin e DITD-së (si p.sh, procesi mësimor, kërkimi shkencor, marrëdhëniet me studentët, mbarëvajtja e provimeve, etj), përgjegjësi i njësisë bazë thërret mbledhjen e Departamentit.
- 2. Zakonisht frekuenca e mbledhjeve është 1 mujore, por ato mund të jenë më të shpeshta vartësisht problematikave të funksionimit të DITD-së.
- 3. Mbledhja mund të filloj kur në të janë të pranishëm 2/3 e personelit akademik dhe ndihmës akademik.
- 4. Vendimarrja merret me shumice të thjeshtë, pra kur votojnë pro mbi 50% e të pranishmëve në mbledhje.
- 5. Njoftimi për zhvillimin e mbledhjes jepet të paktën 1 ditë përpara zhvillimit të mbledhjes, duke përcaktuar axhendën, orën dhe zhvillimin e mbledhjes, si dhe cdo informacion tjetër të nevojshëm për zhvillimin normal dhe diskutimin e problematikave përkatëse.

NENI 6

KOORDINATORI PËR MARËDHËNIET ME STUDENTËT

- 1. Për të koordinuar marrëdhëniet e DITD-së me studentët përgjegjësi i njësisë bazë emëron një prej anëtarëve të stafit akademik të DITD-së për këtë qëllim.
- 2. Koordinator kryen promovimin e programeve të studimit të ofruara nga DITD. Ai informon, orienton dhe këshillon studentët për veprimtarinë mësimore, kërkimore-shkencore dhe aktivitete të tjera.
- 3. Koordinator ofron këshillim për zhvillimin e karrierës në DITD.
- 4. Koordinator këshillon studentët për problematika të ndryshme dhe raporton problematikën e tyre në DITD.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

**NENI 7
GRUPET MËSIMORE – KËRKIMORE.**

1. Grupet mësimore dhe grupet e përherëshme/përkohshme me karakter mësimor dhe kërkimor, janë ministruktura të cilat kryejnë veprimtari akademike dhe kërkimore vetëm brenda Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare. Ato nuk janë njësi përfaqësuese të pavarura dhe të mëvetshme. Veprimtaria e tyre është gjithmonë në funksion tëdetyrave dhe rolit dhe misionit të departamentit.
2. Grupet mësimore-kërkimore kanë përgjegjësin e tyre, i cili propozohet nga përgjegjësi i njësisë bazë, mbi bazën e kuadrin ligjor, nënligjor dhe institucional dhe emërohet nga Dekani. Përgjegjësi i grupit mësimor kërkimor nuk është autoritet derjtues. Ai kryen detyra akademike në funksion të përgjegjësit të njësisë bazë, duke vepruar gjithmonë sipas udhëzimeve të tij.
3. Numri i anëtarëve të grupit mësimor dhe përbërja e tij përcaktohen nga DITD. Numri minimal i anëtarëve të një grupi mësimor përcaktohet nga aktet ligjore, nënligjore dhe institucionale.
4. Grupi përbëhet nga personel akademik efektiv. Si pjesë përbërëse e një grupi mund të jetë edhe personel ndihmës akademik me karakter mësimor.
5. Grupi mësimor-kërkimor (i përkohshëm apo i përhershëm) është përgjegjës për përmbarëvajtjen e procesit mësimor dhe kërkimit shkencor, sipas disiplinave që mbulon grupi.
6. Grupet mësimore kërkimore e zhvillojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me vendimin e Senatit Nr 79, datë 12.12.2016 "Për Funksionimin e grupeve mësimore të përkohshme/të përherëshme kërkimore-shkencore dhe standartet e shpërndarjes së ngarkesës mësimore vjetore në auditor".
7. Grupi i përhershëm/i përkohshëm me karakter kërkimor-shkencor, në funksion dhe në emër të Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare, mund të kryej edhe aktivitet e shërbimit për të tretët duke vepruar sipas dispozitave ligjore në fuqi. Grupi mund të menaxhojë fonde nga fondi bazë i kërkimit shkencor të DITD-së, gjithmonë në funksion dhe për llogari të Departamentit.

**NENI 8
SHPERNDARJA E NGARKESES MESIMORE NE AUDITOR**

1. Ngarkesa mësimore në Auditor është pjesë e kohës vjetore të punës të personelit akademik të Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare.
2. Brenda 10 ditëve pas rifillimit të punës pas pushimeve të verës Përgjegjësi i Njësisë Bazëparaqet për diskutim në mbledhje Departamenti variantin fillestar të shpërndarjes së ngarkesës mësimore në auditor.
3. Varianti fillestar i shpërndarjes së ngarkesës mësimore në auditor diskutohet nga stafi akademik, duke dhënë edhe sygjerimet përkatëse për ndryshime të mundshme në këtë variant.
4. Varianti final i shpërndarjes së ngarkesës mësimore në auditor, i cili reflekton diskutimet e stafit akademik të DITD-së duhe të jetë i përfunduar dhe miratuar nga drejtuesi i njësisë bazë të paktën 1 javë përpara fillimit të procesit mësimor të vitit përkatës akademik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

5. Gjatë shpërndajës së ngarkesë mësimore në auditor mbahen në konsideratë, burimet njërezore në dispozicion, kushtet specifike të zhvillimit të procesit mësimor në vitin përkatës akademik, kuadri ligjor dhe nënligjor, si dhe Vendimi i Senatit Akademik të Universitetit Ismail Qemali të Vlorës, Nr 79, datë 12.12.2016 "Për Funksonimin e grupeve mësimore të përkohshme/të përhershme kërkimore-shkencore dhe standartet e shpërndarjes së ngarkesës mësimore vjetore në auditor".

NENI 9

PUNËSIMI NË DEPARTAMENTIN E INXHINIERIVE DHE TEKNOLOGJISË DETARE

1. Kriteret e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë përcaktohen nga Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare, bazuar në nevojat e saj specifike, dhe miratohen nga Rektori i Universitetit të Vlorës "Ismail Qemali".
2. Konkursi për punësimet në DITD drejtohet nga një komision adhoc, i përbërë në shumicë nga përfaqësues të Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare.
3. Rregullat dhe procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve të komisionit adhoc, si edhe të përzgjedhjes së personelit akademik caktohen në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit të Vlorës "Ismail Qemali".
4. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë, pranë Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare nuk mund të punësohet si personel akademik me kohë të plotë në një institucion tjetër të arsimit të lartë, brenda dhe jashtë vendit.
5. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë, pranë Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare mund të angazhohet me kohë të pjesshme vetëm në një institucion tjetër të arsimit të lartë, me miratimin e drejtuesit të njësisë bazë "Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare" dhe të Rektorit të Universitetit të Vlorës "Ismail Qemali", si dhe në marrëveshje mes institucioneve.
6. Pjesëmarrja e personelit akademik i punësuar me kohë të plotë pranë Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare në projekte, konsulencë, botime dhe shërbime që realizohen në Universitetin e Vlorës "Ismail Qemali" nuk konsiderohet si dypunësim brenda institucionit.
7. Kriteret e punësimit të personelit ndihmësakademik me kohë të plotë, në Departamentin e Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare, propozohen nga njësi bazë "Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare", bazuar në nevojat specifike të Departamentit.
8. Konkursi për punësimet për personel ndihmës akademik në DITD drejtohet nga një komision adhoc, i përbërë në shumicë nga përfaqësues të njësisë bazë Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare.
9. Rregullat dhe procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve të komisionit adhoc, si edhe të përzgjedhjes së personelit ndihmësakademik caktohen në aktet e brendshme institucionale të Universitetit të Vlorës "Ismail Qemali".

NENI 10





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

**KRITERET E PUNËSIMIT TË PERSONELIT AKADEMIK ME KOHË TË PLOTË NË
DEPARTAMENTIN E INXHINIERIVE DHE TEKNOLOGJISË DETARE.**

1. Kriteret e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë në Departamentin e Inxhinierive dhe Teknologjive Detare, të cilat pasqyrohen në thirrjen për punësim pranë Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare, grupohen në:
 - a. Kriteria ose kërkesa të përgjithshme të punësimit si Personel Akademik me kohë të plotë.
 - b. Kriteria bazë të punësimit si Personel Akademik me kohë të plotë.
 - c. Kriteria specifike të punësimit si Personel Akademik me kohë të plotë.
2. Kriteret ose kërkesat e përgjithshme të punësimit të Personelit Akademik me kohë të plotë përcaktohen në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit të Vlorës "Ismael Qemali".
3. Kriteret bazë të punësimit si Personel Akademik me Kohë të plotë Departamentin e Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare, janë përkatësia e diplomës së studimit dhe nota mesatare e kandidatit. Kandidatët duhet të zotërojnë diploma studimi/tituj studimi në të paktën një cikël studimi (përfshirë diplomën Master Profesional) në fushat në të cilat kërkohet të bëhet punësimi. Kandidatët duhet të kenë notën mesatare mbi 8 (tetë), në çdo cikël studimi (Bachelor, Master i Shkencave, Master i Nivelit të Dytë).
4. Diplomën dhe notat e mesatare të programeve të studimit Master Profesional nuk merren në konsideratë për efekt punësimi si personel akademik.
5. Kriteret specifike të punësimit përcaktohen nga DITD, vartësisht thirrjes specifike të punësimit.
6. Kandidatët të cilët nuk plotësojnë/përmbushin kërkesat/kriteret e përgjithshme dhe ato bazë skualifikohen nga procedura e konkurimit për punësim në DITD. Komisionet AD-HOC në këto raste ndërpresin vazhdimin e procedurës së konkurimit për këta kandidatë dhe nuk i përfshijnë ata në tabelat e pikëzimit.

NENI 11

**KRITERET E PUNËSIMIT TË PERSONELIT AKADEMIK ME KOHË TË PJESËSHME
NË DEPARTAMENTIN E INXHINIERIVE DHE TEKNOLOGJISË DETARE.**

1. Kriteret e punësimit të personelit akademik me kohë të pjesshme në Departamentin e Inxhinierive dhe Teknologjive Detare, të cilat pasqyrohen në thirrjen për punësim pranë Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare, grupohen në:
 - a. Kriteria ose kërkesa të përgjithshme të punësimit si Personel Akademik me kohë të plotë.
 - b. Kriteria bazë të punësimit si Personel Akademik me kohë të plotë.
 - c. Kriteria specifike të punësimit si Personel Akademik me kohë të plotë.
2. Kriteret ose kërkesat e përgjithshme të punësimit të Personelit Akademik me kohë të plotë përcaktohen në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit të Vlorës "Ismael Qemali".
3. Kriteret bazë dhe kriteret specifike të punësimit si Personel Akademik me Kohë të pjesshme në Departamentin e Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare, përcaktohen nga DITD, vartësisht thirrjes specifike të punësimit.
4. Diplomën dhe notat e mesatare të programeve të studimit Master Profesional nuk merren në konsideratë për efekt punësimi si personel akademik.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

NENI 12

**KRITERET E PUNËSIMIT TË PERSONELIT NDIHMËS AKADEMIK NË
DEPARTAMENTIN E INXHINIERIVE DHE TEKNOLOGJISË DETARE.**

1. Kriteret e punësimit të personelit ndihmës akademik në Departamentin e Inxhinierive dhe Teknologjive Detare, të cilat pasqyrohen në thirrjen për punësim pranë Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare, grupohen në:
 - a. Kriteria ose kërkesa të përgjithshme të punësimit si Personel ndihmës Akademik.
 - b. Kriteria bazë të punësimit si Personel ndihmës Akademik.
 - c. Kriteria specifike të punësimit si Personel ndihmës Akademik.
2. Kriteret ose kërkesat e përgjithshme të punësimit të Personelit ndihmës Akademik përcaktohen në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit të Vlorës "Ismail Qemali".
3. Kriteret bazë dhe kriteret specifike të punësimit si Personel ndihmës Akademik në Departamentin e Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare, përcaktohen nga DITD, vartësisht thirrjes specifike të punësimit.

NENI 13

STATUSI DHE TRAJTIMI I VECANTE I PERSONELIT AKADEMIK

1. Personeli akademik i DITD-së, si pjesë përbërëse e stafit akademik të UV-së gëzon status dhe trajtim të veçantë, sipas përcaktimeve që parashikohen në VKM Nr. 329, datë 12.4.2017 PËR STATUSIN DHE TRAJTIMIN E VECANTË TË PERSONELIT AKADEMIK dhe Statutit të Universitetit të Vlorës "Ismail Qemali". Statusi dhe trajtimi i vecante i personelit akademik konsiston në liritë akademike, të drejtat ekonomiko-financiare, detyrimet e përgjegjësitë si dhe garancitë juridike e civile në zbatim të tyre.
2. Personeli akademik i DITD-së gëzon liri akademike në këto drejtime të veprimtarisë së tij, në:
 - a) mësimdhënie;
 - b) punë kërkimore-shkencore;
 - c) kontribut institucional;
 - d) kontribut profesional.
3. Liria akademike ushtrohet në kuadrin e përgjegjëshmërisë pedagogjike e shkencore dhënuq presupozon përjashtimin nga vlerësimi i performancës së personelit akademik.
4. Personeli akademik nuk mund të largohet apo të zëvendësohet, pa miratimin e tij, gjatë kryerjes së punës kërkimore-shkencore në një projekt të ndjekur prej tij, përveç rasteve të shkeljeve të rënda të vërtetuara, të parashikuara në Kodin e Punës dhe aktet e brendshme të institucionit të arsimit të lartë.
5. Personeli akademik, brenda kohës efektive të punës, mund të kryejë detyra akademike, shkencore ose në mbështetje institucionale ndaj të tretëve, në përputhje me statutin dhe rregulloret e Universitetit të Vlorës "Ismail Qemali".
6. Personeli akademik, për aktivitete që lidhen me drejtimit e punës së tij, sipas pikës 2, të këtij neni, ka të drejtën e përfitimit të një leje deri në dy javë, me miratim nga drejtuesi i njësive kryesore, që informon, në çdo rast, rektorin. Për kohëzgjatje mbi dy javë, leja merret nga rektori. Në të gjitha rastet, kërkesat për leje duhet të jenë të dokumentuara dhe të justifikuara. Personeli akademik raporton përpara departamentit mbi aktivitetin e kryer gjatë lejes. Kërkesa për leje i drejtohet drejtuesit të njësive bazë 10 ditë (pune) përpara fillimit të përfiktimit të lejes.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

7. Detaje të tjera lidhur me statusin dhe trajtimin e vecantë të personelit akademik përcaktohen në VKM Nr. 329, datë 12.4.2017 PËR STATUSIN DHE TRAJTIMIN E VEÇANTË TË PERSONELIT AKADEMIK dhe Statutit të Universitetit të Vlorës "Ismail Qemali"

NENI 14

TË DREJTAT DHE DETYRAT E PERSONELIT AKADEMIK

1. Përveç sa përcaktohen në ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Kodin e Punës, Statutin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlore dhe në kontratat kolektive ose individuale të punës, personeli akademik ka edhe këto të drejta:
 - a) Të shfrytëzojë të gjitha mundësitë që ofron universiteti, fakulteti dhe departamenti, duke respektuar rregullat e vendosura.
 - b) Të kërkojë të respektohen dhe të zbatohen të gjitha detyrimet që shtrohen gjatë procesit mësimor.
 - c) Të kërkojë nga organet drejtuese të departamentit, fakultetit dhe universitetit, respektimin e të gjitha të drejtave që burojnë nga Kodi i Punës dhe Ligji për Arsimin e Lartë.
 - d) Të kërkojë nga studentët një frymë etike dhe morale në pajtim me legjislacionin në fuqi.
2. Personeli akademik ka edhe këto detyra:
 - a. Të hartojë sipas afateve të përcaktuara nga departamenti, programin e mësimdhënies dhe syllabusin e kursit të cilin ua bën të njohur studenteve, dhe një kopje e të tij duhet t'a dorëzojë në departament.
 - b. Të shfrytëzojë me efektivitet orën e mësimit duke iu përmbajtur orarit mësimor.
 - c. Të ndjekë sistematikisht zhvillimin dhe arritjet e shkencës sipas profilit përkatës në planin kombëtar e ndërkombëtar dhe ta reflektojë atë në procesin mësimor.
 - d. Të hartojë në kohën e duhur tezat e provimit.
 - e. Të dorëzojë në kohë në sekretarinë mësimore rezultatet e vlerësimit të studentëve.
 - f. Të depozitojë në kohë në sekretarinë e departamentit testet e provimeve, të cilat ruhen të pakten deri në përfundim të provimeve të semestrit të ardhshëm.
 - g. Të zbatojë udhëzimet në fuqi gjatë realizimit të programit mësimor.
 - h. Të respektojë gjatë gjithë veprimtarisë së tij parimet e etikës qytetare, Kodin e Etikës së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, duke shfaqur një figurë të pajtueshme me veprimtarinë që zhvillohet në universitet.
 - i. Të respektojë me përgjegjësi orarin mësimor e zyrtar dhe disiplinën në punë;
 - j. Të japë me përgjegjësi informacion mbi realizimin e procesit të mësimdhënies, kërkimit shkencor, kontributit në institucion dhe aspekteve tjera të punës, sa herë që kjo i kërkohet nga autoritetet drejtuese të departamentit, fakultetit dhe universitetit.
 - k. Përpara fillimit të çdo semestri personeli akademik me kohë të plotë, merr miratimin nga përgjegjësi i departamentit, nga dekani i njësisë kryesore dhe nga rektori, për aktivitetin mësimor me kohë të pjesshme që mund të kryejë në institucione të tjera të arsimit të lartë.
 - l. Të realizojë normën e ngarkesës mësimore dhe mbingarkesën në raste nevojë.

NENI 15

PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK


1. Programet e ciklit të parë të studimit, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, organizohen me jo më pak se 180 krediteeuropiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është tri vite akademike. Në përfundim të këtyre programeve lëshohet diploma "Bachelor" në fushën e arsimimit të kryer.
2. Në të gjitha programet e studimit të ciklit të parë, të ofruara nga Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare, studentët në përfundim të programit të studimit studentët mund të diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar, ose me punim diplome.
3. Pragu i notës mesatare për zhvillimin e punimit të diplomës përcaktohet në Rregulloren e Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës dhe Vendimeve të Senatit Akademik.
4. Kanë të drejtë për tu pranuar në programet e studimeve të ciklit të parë, kandidatët të cilët kanë përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me Vendim të Senatit Akademik të Universitetit të Vlorës, në përputhje me Vendimet e Këshillit të Ministrave.
5. Brenda afateve të përcaktuara nga Institucioni DITD propozon kuotat dhe kriteret shtesë të pranimit të studentëve në programet e studimit të ciklit të parë të ofruara prej saj.

NENI 16 PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË

1. Sikli i dytë i studimeve përfshin programet e studimit "Master i shkencave", "Master i arteve" dhe "Master profesional", referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Në të gjitha programet e studimit të ciklit të dytë, të ofruara nga Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare (përfshijë programin e studimit Master i Shkencave) studentët në përfundim të programit të studimit studentët mund të diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar, ose me punim diplome.
3. Pragu i notës mesatare për zhvillimin e punimit të diplomës përcaktohet në Rregulloren e Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës dhe Vendimeve të Senatit Akademik.
4. Kanë të drejtë për tu pranuar në programet e studimeve të ciklit të dytë, kandidatët të cilët kanë përfunduar me sukses një program studimi të ciklit të parë, të përshtatshëm për vazhdimin e programeve të studimit të ciklit të dytë të ofruara nga DITD dhe plotësojnë kriteret e vendosura nga DITD.
5. Brenda afateve të përcaktuara nga Institucioni DITD propozon kuotat dhe kriteret shtesë të pranimit të studentëve në programet e studimit të ciklit të dytë të ofruara prej saj.

NENI 17 TEKSTET MËSIMORE

Tekstet mësimore të rekomandueshme për pjesën teorike dhe të detyrueshme për seminarët, ushtrimet dhe punët laboratorike duhet të miratohen nga departamenti, me propozimin e titullarëve të lëndëve. Këto u bëhen të njohura studentëve me fillimin e kursit të lëndës.





REPUBLIKA E SHQIPËRIË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

**NENI 18
FREKUENTIMI I OREVE MËSIMORE DHE DETYRIMI I PARAQITJES NË
PROVIM**

Frekuentimi i orëve mësimore është i detyrueshëm deri në masën 75%.

Numri i mungesave të lejuara përlllogaritet për gjithë semestrin përkundrejt numrit total të orëve për gjithë kursin dhe jo në bazë të orëve që i takojnë provimeve të pjesshme. Nëse studenti mungon gjatë zhvillimit të kursit dhe tejkalon numrin total të mungesave të lejuara për gjithë semestrin, atëherë studenti skualifikohet për shkak të mungesave, nuk futet në provimin e radhës, në procesverbalin e vlerësimit shënohet mungesë (m) dhe përsërit kursin në semestrin e ardhshëm kur kursi ofrohet. Shënimi mungesë (m) do të pasqyrohet në procesverbalet përfundimtare nëse studenti ka plotësuar mungesat totale. Nëse studenti ka frekuentuar kursin por nuk paraqitet në provimin e radhës, në procesverbalin e vlerësimit shënohet "Nuk u paraqit". Nëse studenti nuk ka detyrime frekuentimi, por nuk është paraqitur në asnjë prej provimeve të pjesshme duke përfshirë dhe provimin final, në procesverbalin përfundimtar të vlerësimit do të bëhet shënimi "NP" (Nuk u paraqit), në të kundërt do të bëhet vlerësimi me notën përkatëse. Studentët e të gjithë cikleve nuk mund të regjistrohen në këto lëndë për të ndjekur kursin si përsëritës, por kanë të drejtën të shlyejnë lëndën vetëm me provim, sipas përcaktimeve në këtë rregullore. Sekretaria mësimore e DITD-së përgjigjet për administrimin e informacionit mbi frekuentimin e studentëve.

**NENI 18
SISTEMI I VLERËSIMIT**

Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10. Nota më e ulët kaluese është nota 5 (pesë). Në procesverbalet e vlerësimit përfundimtar për studentin jo kalues (ngelës) vendoset nota 4 (katër). Në të gjitha format e kontrollit të dijes përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht kthehet në notë.

**NENI 19
RREGULLAT E ZHVILLIMIT TË PROVIMEVE DHE VLERËSIMI**

Kontrolli i dijes së një lënde (provimi) përcaktohet nga titullari i lëndës dhe mund të bëhet, me shkrim, me gojë ose i kombinuar me shkrim e me gojë, duke u mbështetur në programin mësimor. Në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë kontrolli i dijeve në ciklin e parë të studimeve realizohet përgjatë semestrit nëpërmjet një provimi të pjesshëm, një provimi final gjithë përfshirës si dhe formave të tjera të vlerësimit nëse janë parashikuar në syllabus-in e lëndës. Në ciklin e dytë të studimeve kontrolli i dijeve realizohet nëpërmjet një provimi të vetëm. Orari i provimeve finale duhet të shpallet para përfundimit të semestrit. Për sezonin e verës dhe sezonin e riprovimeve të dimrit kontrolli i dijeve realizohet vetëm nëpërmjet një provimi final. Rregulla apo specifika të provimeve, pesha (përqindja) e secilit provim apo detyrë në vlerësimin përfundimtar, literatura, temat ose pjesët e programit të lëndës për çdo provim, dita apo java e provimit, ora dhe salla e zhvillimit, referencat e konvertimit të pikëve në notë etj, përcaktohen në syllabus-in e lëndës të hartuar nga pedagogu dhe u bëhet i ditur studentëve që ndjekin atë kurs.



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

Pesha (përqindja) e provimit të pjesshëm, të jetë nga 25-30% e vlerësimit të përgjithshëm dhe zhvillohet jo më larg se java e shtatë, ndërsa 10-15% e vlerësimit të përgjithshëm, mund të bazohet në detyrat e kursit, projektet individuale, apo forma të tjera të vlerësimeve gjatë vitit, të gjitha së bashku. Në rastin kur studenti nuk merr pjese në një provim, por paraqet dokumentacion ku justifikon arsye të forta si probleme shëndetësore serioze (psh. shtrim në spital, aksident të rëndë), raste të jashtëzakonshme fatkeqësish familjare, apo raste urgjencash publike, vendimin për një mundësi tjetër për dhënien e provimit e merr dekani i fakultetit përkatës, duke u bazuar në kërkesën me shkrim së paraqitur nga studenti. Dekani ka të drejtë të kërkojë dokumentacion shtesë për të verifikuar mungesën.

Kurset janë të gjitha semestrale. Nëse studenti nuk kualifikohet, pra ka shënim mungesë (m) në proceverbalin përfundimtar të kursit, ai ka të drejtën dhe detyrimin ta frekuentojë përsëri atë, në semestrat pasardhës kur kursi ofrohet. Nëse kursi për arsye të ndryshme nuk do të ofrohet më (psh. ndryshimet e mundshme në kurrikula), studenti ka të drejtë të frekuentojë kursin përkatës zëvendësues. Kështu, krahas kurseve të përcaktuara në planet semestrale, studenti ka të drejtë të frekuentojë njëkohësisht edhe kurse të tjera ku figuron mbetës nga semestrat paraardhës, por duke respektuar rregullat e numrit të krediteve të regjistruara në një semestër dhe rregullat e përgjithshme të regjistrimit.

Tezat e provimit në të gjitha kontrollet hartohen nga titullari i lëndës dhe miratohen nga drejtuesi i njësisë bazë. Kompromentimi i tezës është përgjegjësi direkte e pedagogut.

Pas përfundimit të çdo provimi apo formave të tjera të kontrollit të dijeve, rezultatet editohen në Sistemin informative të Universitetit të Vlorës jo më larg se 48 orë nga dita e zhvillimit të tij. Një ditë pas shpalljes së rezultateve, pranohen dhe vlerësohen ankesat e studentëve dhe printohet procesverbali nga sistemi, firmoset nga lektori dhe dorëzohet në sekretarinë mesimore.


Në raste paqartësish, studentët kanë të drejtë të shikojnë personalisht provimin në prezencë të lektorit të kursit, për të marrë sqarimet e duhura. Për sqarime të mëtejshme, në lëndët me kodet MEK, NAV, EGR, EE, studentët kanë të drejtë t'i drejtohen me shkrim përgjegjësit të departamentit lidhur me ankesën e tyre. Ankesat e studentëve trajtohen sipas përcaktimeve të kësaj Rregulloreje dhe të Rregullores së përgjithëshme të Univesritetit të Vlorës "Ismail Qemali".

Në fund të çdo provimi, testet dhe çdo material i provimit dorëzohet në sekretarinë e departamentit përkatës, mbyllet në një zarf të mbi të cilin të jenë shkruar të gjitha të dhënat e nevojshme dhe firmoset nga lektori. Zarfet me testet e provimeve të arkivuara në sekretarinë e departamentit, mund të hapen dhe të kontrollohen vetëm në rast ankimi ose shihet e arsyeshme nga autoritetet drejtuese. Këto materiale ruhen deri në fund të provimeve të semestrit pasardhës e më pas ato digjen.

NENI 20 PRAKTIKA PROFESIONALE

Studentët kanë të detyrueshme kryerjen e praktikës profesionale, kur ajo përfshihet në programin e studimit. Me fillimin e vitit akademik, DITD u komunikon studentëve kohën e kryerjes, programin, mënyrën e zhvillimit dhe shlyerjes së saj.

Praktikat profesionale zhvillohen në institucione/ndërmarrje prodhimi apo shërbimi sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e pedagogut të caktuar nga departamenti, sipas





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

marrëveshjeve tip që lidhen për këtë qëllim. Studenti detyrohet të respektojë rregullat e institucionit ku kryen këtë proces.

Gjatë kryerjes së praktikës profesionale, personeli akademik që drejton atë, ushtron kontroll të vazhdueshëm dhe mban lidhje me qendrën ku ajo kryhet. Në përfundim të praktikës profesionale, studenti përgatit një relacion për punën e kryer e cila vlerësohet nga pedagogu që e drejton praktikën pasi merr edhe mendimin e qendrës ku është kryer ajo. Vlerësimi bëhet me notë.

NENI 21 TË DREJTAT E STUDENTËVE

Studenti ka të drejtë:

1. Të ndjekë leksione, seminare dhe të gjitha veprimtaritë e tjera mësimore, të organizuara në përputhje me statusin e tij.
2. Të përdorë pajisjet, bazen materiale dhe laboratorike të Universitetit/Fakultetit/Departamentit sipas rregullave përkatëse, për të realizuar programin mësimor dhe punën e programuar në aktivitetin e tij shkencor, bibliotekën dhe mjediset sportive e kulturore të universitetit.
3. Të zgjedhë dhe të zgjidhet në organet drejtuese
4. Të organizohet në shoqata të ndryshme jopolitike në përputhje me aktet ligjore e nënligjore përkatëse.
5. Të përfitojë bursë studimi brenda ose jashtë shtetit kur plotëson kushtet e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, Senatit e në marrëveshjet ndërshtetërore ose ndëruniversitare.
6. Të përfitojë shpërblime të veçanta që akordohen nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë sipas ligjit dhe kriterëve të caktuar nga Senati Akademik.
7. Të shprehë opinionin e tij për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të universitetit.
8. Të ankohet për shkelje të rregullave dhe standarteve akademike nga ana e pedagogëve, të mosrealizimit të procesit të mesimdhënies, të rregullave të zhvillimit të provimit dhe për vlerësimin e tij të pamerituar.
9. Të ankohet për shkelje të etikës akademike, të konfliktit të interesit dhe të çdo rasti tjetër që çënon integritetin e studentit.
10. Të drejta të tjera të studenteve përcaktohen në Ligjin për Arsimin e Lartë, kuadrin ligjin dhe nënligjor dhe në Rregulloren dhe Statutin e Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës.

NENI 22 DETYRAT E STUDENTËVE

Studenti është i detyruar:

1. Të njohë me hollësi statutin, rregulloren e universitetit, rregulloren e Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare dhe çdo rregullore tjetër e detyrimit që lindin për të





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

- dhe të jetë i vetëdijshëm për zbatimin e tyre; në të kundërt, universiteti nuk mban përgjegjësi për pasojat që mund të rrjedhin nga mosnjohja e tyre;
2. Të njohin të gjitha kërkesat e përgjithshme të universitetit, si dhe kërkesat specifike të programit në fushën që ata kanë zgjedhur. Studentët janë përgjegjës për t'iu përgjigjur të gjitha kërkesave dhe rregulloreve përkatëse në bazë të diplomave që ata synojnë;
 3. Të zbatojnë të gjitha rregullat që rrjedhin nga Statuti dhe Rregullorja e Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës, dhe nga çdo akt tjetër ligjor e nënligjor për arsimin e lartë;
 4. Të respektojnë Kodin e Etikës së universitetit.
 5. Të shlyejë detyrimet e përcaktuara në programin e studimit si dhe çdo detyrim tjetër financiar dhe material ndaj universitetit;
 6. Të shlyejë të gjitha detyrimet financiare të parashikuara në ligj.
 7. Të mbajë përgjegjësi për shkeljet e rregullave të universitetit nga ana e tij; dëmet materiale që ai mund të ketë bërë zhdëmtohen në masën e përllogaritur.
 8. Detyra apo përgjegjësi të tjera të studenteve përcaktohen në Ligjin për Arsimin e Lartë, Kuadrin ligjor dhe nën ligjor dhe në Rregulloren dhe Statutin e Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës.

ENI 23

RREGULLAT E REGJISTRIMIT DHE ORGANIZIMI I KURSEVE

Studentët e çdo programi studimi të ciklit të parë, të dytë regjistrohen online nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Univlora në kurset që i ofrohen sipas planit mësimor.

Çdo lëndë apo kurs ka kodin e vet të përbërë nga tre shkronja që tregojnë disiplinën apo fushën e studimit, dhe një numër treshifror që tregon se për studentet e cilit vit janë hartuar këto kurse.

DITD është përgjegjëse për mbarëvajtjen e kurseve me kodet MEK, NAV, EGR, EE. Kurset me numra 100-199 janë kurse universitare hyrëse dhe i perkasin lendeve te programeve te studimit qe jane planifikuar për studentë të vitit të parë. Kurset me numra 200-299 janë të hartuara për studentë të vitit të dytë, ndërsa kurset me numra 300-399 janë të hartuara për studentë që janë në vitin e fundit të diplomimit të ciklit të parë. Kurset me numër 400-599 u perkasin lëndëve të programeve të studimit të ciklit të dytë.

Çdo student në ciklin e parë të studimeve mund të regjistrohet për kurse deri 40 kredite në semestër, pasi më parë të regjistrohet në lëndët që ofrohen në atë sezon në të cilat nuk është regjistruar asnjëherë. Bazuar në këtë rregull e drejta e plotësimit të krediteve të mundshme të regjistrimit në një semestër, i jepet vetëm për lëndët të cilat në transkript kanë shënimin mungesë (m).

Nëse studenti i ciklit të parë ka siguruar gjatë kohës së studimeve të paktën 110 kredite, ai mund të regjistrohet në lëndë sipas rregullit të përgjithshëm (pra të regjistrohet paraprakisht në lëndët e reja, në të cilat nuk është regjistruar asnjëherë më parë) dhe e drejta e plotësimit të krediteve të mundshme të regjistrimit në një semestër, i jepet për të gjitha lëndët të cilat në transkript kanë shënimin mungesë (m), notën 4(katër) ose "NP" (Nuk u paraqit).

Duke respektuar rregullin e përgjithshëm të regjistrimit të kurseve të përcaktuar në paragrafin 3 dhe 4 të këtij neni, çdo student i ciklit të parë i cili ka siguruar të paktën 30 pikë kredite, ka të drejtën e regjistrimit edhe në kurset me kodet e numrave 200-299 dhe nëse ai ka siguruar të



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

pakten 90 pikë kredite, mund të regjistrohet në të gjitha kurset, përfshirë edhe ato të vitit të tretë të studimeve në programin përkatës.

Të gjithë studentët koha e studimeve të të cilëve në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë ka zgjatur të paktën tre vite pa përfshirë lejen akademike dhe nuk kanë mundur të sigurojnë kreditet e mjaftueshme për t'u regjistruar në lëndë të vitit pasardhës, u jepet mundësia e regjistrimit në kurset e sezonit përkatës. Ky regjistrim kryhet nga sekretariteti mësimor, referuar kërkesës së studentit, duke respektuar rregullin e përgjithshëm të regjistrimit, pasi më parë është bërë verifikimi.

Studentët e ciklit të dytë të studimeve regjistrohen në lëndët që ofrohen në atë sezon sipas planit mësimor, në të cilat nuk është regjistruar asnjëherë më parë. Kur studimet zgjasin përtej kohës normale të tyre, e drejta e plotësimit të krediteve të mundshme të regjistrimit në një semestër i jepet vetëm për lëndët që nuk ka frekuentuar të cilat në transkript kanë shënimin mungesë (m) dhe që ofrohen në atë sezon sipas planit mësimor.

NENI 24

PROPOZIMET PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT OSE NDRYSHIMEVE NË PROGRAMET EKZISTUESE TË STUDIMEVE

1. Të drejtën e propozimit për hapjen e programeve të reja të studimi, ose ndryshimeve në programet ekzistuese të studimit e kanë drejtuesi i njësisë bazë, përgjegjësit e grupeve mësimore kërkimore, si dhe cdo anëtar tjetër nga asambleja e personelit akademik të DITD-së.
2. Në të gjitha rastet propozimi duhet të shoqërohet me argumentat dhe dokumentacionin përkatës, në përputhje me kuadrin ligjor, nënligjor dhe institucional.
3. Me marrjen e propozimit drejtuesi i njësisë bazë therret mbledhjen e departamentin për shqyrtimin e propozimit. Departamenti vendos lidhur me propozimin për hapjen e një programi të ri studimi, ose ndryshimeve të një programi ekzistues dhe grupin e punës për përgatitjen e dokumentacionit përkatës.
4. Grupi i punës është përgjegjës për përgatitjen e materialit përkatës conform kërkesave ligjore dhe institucionale. Materiali i përgatitur nga grupi i punës shqyrtohet nga DITD, në një mbledhje Departamenti, ku miratohet variant përfundimtar.
5. Drejtuesi i njësisë bazë, përcjell variantin përfundimtar të miratuar nga DITD, pranë Autoriteteve dhe/ose Organeve të tjera drejtuese për vazhdimin e procedurës.

NENI 25

TRAJTIMI I ANKESAVE

1. Personelit Akademik, ndihmës akademik dhe studentëve për probleme të lidhura, me jetën akademike, kërkimore-shkencore, mbështetjes institucionale, zhvillillimit të procesit mësimor dhe të provimeve, etj u lind e drejta e ankimit sa herë që ata konstatojnë që u janë shkelur të drejtat e tyre, ose vënë re parregullsi gjatë zhvillimit të këtyre aktiviteteve.
2. Në të gjitha rastet ankesat i drejtohen me shkrim Drejtuesit të njësisë bazë.
3. Në vartësi të cdo rasti specifik ankesa mund të shqyrtohet nga Drejtuesi i Njësisë Bazë ose prej një Komisioni Ad-hoc i ngritur nga Drejtuesi i njësisë bazë për shqyrtimin e ankesës.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK**

4. Brenda pesë ditëve nga marrja e ankesës dhe/ose ngritja e Komisionit Ad-Hoc i jepet përgjigje ankimuesit lidhur me ankesën e tij.
5. Ankimuesi ka të drejtë tu drejtohet Autoriteve ose Organeve të tjera drejtuese Brenda UV-së në rast se nuk është dakort me përgjigjen e dhënë.

NENI 26

**RISHIKIMI I RREGULLORES SË DEPARTAMENTIT TË INXHINIERIVE DHE
TEKNOLOGJISË DETARE**

1. Rregullorja e DITD-së është objekt i rishikimeve apo ndryshimeve të mundshme.
2. Rregullorja mund të rishikohet apo të ndryshoj vetëm me vendim Departamenti.

